

Thirrje e hapur

Për tridhjetë (30) kandidatë për një program
pesëmuor të punës praktike

Prishtinë/Priština 27 Mars 2023

Departamenti i Demokratizimit
Seksioni për Pjesëmarrje Publike

Projekti BU 2101180 “Rritja e kapaciteteve dhe aftësive për pjesëmarrje demokratike sociale (Faza 2)”

Aktiviteti 2.6. “Programi i vitit 2023 për punë praktikë në nivel komunal”

Informata të përgjithshme:

Pjesëmarrja publike e të rinjve në vendimmarrje garantohet dhe promovohet përmes një kornize normative dhe të politikave që rregullon fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë së Kosovës. Kjo kornizë përfshin Ligjin për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, katër udhëzime administrative¹, si dhe Strategjinë për rininë që i përcakton prioritetet dhe synimet për periudhën 2019-2023.

Të rinjtë kanë të drejta dhe mundësi për të kontribuar në vendimmarrje dhe politikëbërje, qoftë drejtpërdrejt ose përmes organeve ekzistuese përfaqësuese si Këshilli Rinor i Kosovës, këshillat e veprimit rinor lokal (KVRL), Këshilli Studentor i Kosovës dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile.

Megjithatë, të rinjtë shpeshherë e kanë të pamundur që t’i ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kontribuojnë plotësisht në proceset vendimmarrëse për dy arsye: nga njëra anë, të rinjve mund t’u mungojnë informatat, përvoja dhe aftësitë e mjaftueshme teknike, ndërsa nga ana tjetër mundësitë e ofruara nga institucionet publike për t’i përfshirë ata në mënyrë domethënëse në vendimmarrje dhe politikëbërje janë të kufizuara. Si rezultat, të rinjtë dekurajohen dhe/ose përjashtohen nga ushtrimi i së drejtës së tyre për pjesëmarrje dhe izoloohen gradualisht nga sfera e vendimmarrjes.

OSBE promovon pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes përmes një qasjeje të pjesëmarrjes ndërvepruese të bazuar në parimin “të mësosh duke bërë” dhe të pajisjes së tyre me aftësi e njohuri të përshtatshme që mund të barten tek të tjerët.

Këtë vit, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet komunale dhe organizatat partnere të shoqërisë civile (OSHC), OSBE do të mbështesë organizimin e një programi pesëmuor të punës praktike për 30 të rinj dhe të reja të moshës 20 deri në 24 vjeç. Programi synon që t’i afrojë të rinjtë dhe të rejat me institucionet e pushtetit lokal dhe OSHC-të përkatëse, duke i angazhuar ata drejtpërsëdrejti në proceset pjesëmarrëse dhe në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes në nivel lokal.

¹ UA nr. 13/2010 për funksionimin e depoz qendrore të MKRS-së; UA nr. 10/2010 për punën vullnetare të të rinjve; UA nr. 12/2010 për arsimin joformal të rinjve; UA nr. 06/2010 për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Trashëgimisë Kulturore

Në bazë të profileve dhe interesave të aplikuesve dhe duke marrë parasysh nevojat e institucioneve dhe organizatave partnere, praktikantët/et e përzgjedhur do të vendosen nëpër zyra/divizione/drejtori të ndryshme të komunave dhe OSHC-ve partnere në mbarë Kosovën. Institucionet/organizatat partnere do të ftohen që të emërojnë mbikëqyrës/koordinator të programit të cilët/cilat do ta orientojnë dhe monitorojnë punën e praktikantëve/eve gjatë tërë periudhës sa do të zgjasë puna praktike.

Fillimi i programit të punës praktike do të shënohet me një ngjarje inauguruese, ku do të paraqiten: (i) qëllimi dhe objektivat e programit dhe (ii) rëndësia e avancimit të përfshirjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes në nivel lokal.

Programi do të përfundojë në nëntor të vitit 2023 me një konferencë përmbyllëse të organizuar bashkërisht nga OSBE-ja dhe institucionet/organizatat partnere, ku praktikantët/et do të angazhohen dhe do të lehtësojnë diskutimet për tema që lidhen me pjesëmarrjen publike të të rinjve.

Synimi

OSBE synon t'u mundësojë 30 të rejave dhe të rinjve që të fitojnë përvojë profesionale përkatëse në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes në nivel lokal përmes një programi pesëmuor të punës praktike në institucionet e pushtetit lokal dhe OSHC-të partnere të përzgjedhura.

Detyrat

Varësisht nga natyra e punës dhe drejtoritë/divizionet/sektorët e institucioneve të pushtetit lokal ose OSHC-ve partnere, praktikantët/et do të kenë për detyrë që të:

- Ndihmojnë në:
 - përpilimin e opinionëve dhe komenteve për propozimet e politikave;
 - përgatitjen e raporteve të brendshme dhe të jashtme;
 - kryerjen e proceseve të brendshme të planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit;
 - zbatimin e projektit(eve) dhe nismave;
 - kryerjen e hulumtimeve dhe analizave nga zyra.
- Hartojnë një plan për komunikim të rregullt me mbikëqyrësin/koordinatorin e caktuar të programit;
- Kryejnë detyra të tjera të caktuara nga mbikëqyrësi/koordinatori i emëruar i programit;
- Të marrin pjesë në (i) ngjarjen inauguruese dhe (ii) konferencën përmbyllëse.

Rezultatet e pritshme:

- Deri më 16 qershor të vitit 2023, praktikanti/ja i/e përzgjedhur, në koordinim me mbikëqyrësin/koordinatorin e caktuar të programit, duhet të dorëzojë një plan pune me një përshkrim të hollësishëm të detyrave, përgjegjësi dhe rezultateve;
- Deri më 15 nëntor të vitit 2023, praktikanti/ja i/e përzgjedhur duhet të paraqesë një raport përfundimtar të vetëvlerësimit në kuadër të të cilit praktikanti/ja duhet të reflektojë në mënyrë kritike për përvojën e tij/saj, si dhe për rëndësinë e programit për avancimin e tij/saj profesional/angazhimin qytetar;

- Deri më 15 nëntor të vitit 2023, praktikanti/ja i/e përzgjedhur duhet të plotësojë anketën përfundimtare për programin e punës praktikës.

Treguesit e performancës²

- Praktikanti/ja respekton orarin e punës me kohë të pjesshme, sipas planit të punës të dakorduar me mbikëqyrësin/koordinatorin e programit;
- Praktikanti/ja merr pjesë në (i) ngjarjen inauguruese dhe (ii) konferencën përmbyllëse;
- Praktikanti/ja tregon rezultatet e kërkuara (p.sh., plani i punës, raporti përfundimtar, anketa përfundimtare);
- Praktikanti/ja dëshmon njohuri dhe interes të shtuar për proceset e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes në nivel lokal.

Vendndodhja

Kandidatët e përzgjedhur do të punojnë në institucione të përzgjedhura të pushtetit lokal dhe OSHC-ve partnere, ku do t'u sigurohet hapësira dhe materiali i nevojshëm për punë, sipas dëshirës.

Kohëzgjatja

Programi i punës praktikës do të zgjasë pesë muaj (qershor-tetor 2023).

Kandidatët e përzgjedhur duhet të paraqiten në institucionet/organizatat ku do të kryejnë praktikën të paktën 14 ditë pune në muaj, për jo më pak se katër orë në ditë³.

Kualifikimet e nevojshme

- Të jetë i/e moshës 20 deri në 24 vjeç me rastin e paraqitjes së aplikimit;
- Të jetë i/e regjistruar si student në një program universitar;
- Të zotërojë shkëlqyeshëm gjuhën shqipe, serbe, ose të dyja gjuhët, në të folur dhe në të shkruar;
- Zotërimi i mirë i gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar konsiderohet përparësi;
- Të ketë njohuri për përdorimin e aplikacioneve të Windows, përfshirë përpunimin Word-in dhe e-mailin;
- Të dëshmojë vetëdije dhe ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore;
- Gatishmëri për të punuar në ekip.

Kualifikimet e dëshirueshme

- Njohuri bazë për mekanizmat e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes publike në nivel lokal;
- Anëtarësi aktuale ose e mëparshme në strukturat rinore (p.sh., këshillat e veprimt rinor lokal, qendrat rinore etj.) dhe/ose organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në mënyrë aktive në sektorin rinor;
- Të ketë kontribuar si vullnetar/e dhe/ose aktivist/e rinor në nisma/projekte përkatëse.

² Mbikëqyrësi i caktuar në secilin institucion bashkëpunues do të përgatisë një vlerësim të plotë për çdo praktikant në bazë të një formulari të siguruar nga OSBE-ja.

³ Subjekt i dakordimeve të mëvonshme me mbikëqyrësin/koordinatorin e programit në çdo institucion të pushtetit lokal.

Shënim: OSBE-ja është e përkushtuar që të promovojë diversitetin dhe përfshirjen dhe inkurajon kandidatët gra dhe burra të rinj të kualifikuar, si dhe kandidatët me aftësi të kufizuara, nga zonat rurale dhe nga radhët e komuniteteve joshumicë ose grupeve të cënueshme që të aplikojnë në programin e punës praktike.

Kompensimi i propozuar

- Çdo kandidati/eje të përzgjedhur do t'i jepet si kompensim një shumë e përgjithshme prej 70 euro për person/muaj për mbulimin e shpenzimeve të transportit. Kompensimi do të bëhet çdo muaj pas dorëzimit të listave të nënshkruara të paraqitjes në vendin e punës praktike.
- OSBE do të mbulojë koston e policës së sigurimit individual, duke mbuluar incidentet e mundshme në vendin e punës gjatë orarit të punës. Kostoja e policës së sigurimit do të rimbursohet me pagesën e parë mujore, pas dorëzimit të kontratës së nënshkruar të sigurimit dhe dëftesës së pagesës.

Shënim: OSBE-ja nuk do të mbulojë asnjë shpenzim tjetër të bërë nga praktikantët.

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë:

- **Formularin e aplikimit të plotësuar** në linkun më poshtë:
https://www.surveymonkey.com/r/FormulariiAplikimit_OSBE
- Bashkangjesin **CV-në e tyre** me informatat e kontaktit në **Formularin e aplikimit** (maksimumi 1 faqe, në gjuhën angleze, shqipe ose serbe, që përmban informacione në lidhje me kualifikimet e nevojshme dhe të dëshirueshme) në OMIKApprenticeship2023@osce.org;

Afati i fundit për aplikim është **21 prill 2023**.

Pyetjet duhet të dërgohen në: OMIKApprenticeship2023@osce.org.

Procesi i përzgjedhjes do të bëhet nga OSBE-ja në bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe OSHC-të partnere në nivelin lokal.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë mund të ftohen për një intervistë plotësuese me institucionet ose OSHC-të partnere lokale.